

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *Komuna Shtime*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **617-25-7881-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i urave në Shtime, Godanc dhe Pjetershticë**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

*"ARCHING Group" SHPK*

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

*Sheshi Adem Jashari Lipjan*

(Adresa)

*Lipjan*

(Vendi)

(Kodi postar)

*049 969 222*

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

*Ardian Mziu*

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

*arching-group@hotmail.com*

(Adresa elektronike)

*12.09.2025*

(Data e parashtrimt të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtoj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

B05 Njoftim per Kontrat

27.08.2025 15:17

Kërkesë për rishqyrtim -.09.2025 11:30

Vendim per refuzim. 04.09.2025 11:16

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

*Kërkesë për rishqyrtim - 03.09.2025 11:30*

*Vendim për refuzim. - 04.09.2025 11:16*

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Ligji Nr. 04/L-042

**Neni 1**

**Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike,

transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

#### **Neni 6**

##### **Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. 2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

#### **Neni 7**

##### **Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

#### **Neni 28**

##### **Specifikimet teknike**

2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

#### **Pretendimi nr. 1:**

AK NE DT dhe njoftimin për kontrate ka kërkuar tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 6

Raporti për mjetet, stabilimentet dhe paisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit PAISJET QË DUHET TË JENË TË REGJISTRUARA DHE DËSHMUARA ME LIBREZA

**Kamion kiper me kapacitet min.15 ton,(copë 1),**

**Eskavator me goma min.20 ton (copë 1),**

**Makinë vetë shkarkuese (damper me goma). (copë 1),**

**Eskavator me goma 13 ton, (copë 1),**

**Kamion vetshkarkues për pastrim të rrugëve peshë bartëse max.7 ton, (copë 1),  
Lugë ngarkuese max.3ton, (copë 1), G  
jysmerimorkë sinjalizuese me gjenerator max.1 ton, (copë 2),  
Lugë ngarkuese me pirunë dhe fshisa (5-7)ton, (copë 1).**

**Shkeljet ligjore të pretenduara:**

**Nenin 28 pikë 2**

Kërkesat e vendosuar në DT janë kërkesa diskriminuese dhe favorizuese për OE të caktuar, të njëjtat bien në kundërshtime me parimet e prokurimit publike, për faktin se këto paisje, për pos që janë favorizuese dhe diskriminuese, duke e zvogëluar konkurrencën dhe pamundësuar konkurrencën e lirë në konkurshmeri, të njëjtat demtojnë edhe buxhetin e komunës për këtë projekt. Me këtë kërkesë AK ka favorizuar OE që ka këto paisje teknike të njëjta specifike, e cila është e vështirë të gjendet, mos të themi e pamundur. Kërkesat e tilla të vendosura në DT bien në kundërshtim me nenin 1 të LPP-se QELLIMIN, nenin 6 EKONOMICITETI DHE EFIKASITETI, nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.

Kërkesat e vendosuar nga AK në DT duhet të jenë të harmonizuara me natyrën e aktivitetit të prokurimit edhe të njetat të jenë të disponueshme për implementimin e kontratës,

Logjikisht edhe nuk është e nevojshme që një bager, ose një Luge Ngarkuese të jetë me regjistrim, pasi që kjo lloj makinerie operon brenda një vend punishte, e cila me ligj ndertimi kërket të jetë: Vendpunishte e rrethuar e siguruar nga palet tjera, ku nuk duhet të kenë qasje palet e treta!

Paisjet e lartcekura me regjistrim (Bager, dumper, luge ngarkuese etj) janë në sasi të limitime!

Kjo kërkesë nuk është e domosdoshme për funksionin e projektit në fjalë, por vendos kufi të panevojshëm, që nuk lidhet me objektivin e kontratës, duke reduktuar numrin e OE-ve që mund të aplikojnë në këtë dosje tenderi.

Me kërkesën për regjistrim të Bagerave dhe Dumperve • Me këtë përshkrim teknik të ngushtë, AK ka eliminuar nga gara shumë operatorë që kanë mjete të tjera të përshtatshme dhe funksionale, por që nuk i kanë regjistruar, sepse një gjë e tillë s'ka qenë praktike asnjëherë në Kosovë dhe nuk kërket në qindra dosje tjera të tenderve ane e mbanë Kosovës, që shpallen nga AK tjera, për natyrë të njëjtë pune!

Ka me qindra OE që kanë shumë paisje të tilla të njëjta, që operojnë në Kosovë, që marrin punë të ndryshme pranë institucioneve të ndryshme në Kosovë, e që asnjëherë s'janë kërkuar të jenë të regjistruara (kemi raste kur janë punuar edhe rrugë ma specifike si Rrugë Regjionale, Magjistratë, Autostrada etj e nuk janë kërkuar në këtë mënyrë)!

Kjo sjell favorizim të drejtpërdrejtë për një kategori shumë të kufizuar OE-ve që posedojnë këtë lloj makinerie specifike, dhe për pasojë cenon parimin e barazisë në trajtim dhe konkurrencës së ndershme.

**Ne po ua bashkangjesim edhe një vendim të OSHP-s me nr 2024/108 të datës 14/01/2025** ku për të njetën qeshtëje ka vendosur OSHP, dhe besojmë se AK është i obliguar ta zbatoj këtë vendim, sepse për pretendimet e njëjta OSHP ka vendosur një here.

Qudia me e madhe ne kete rast eshte qe , sipas specifikimeve teknike te kesaj dosje, ne nje vend punishte, nje cilinder dhe nje bager qe operojne njekohesisht, njeri mundet me qene me regjistrim e tjetri jo (kujojme se te dyja jan makineri te rende ndertimi)!

Kerkojme qe te largohet ky kriter diskriminues per paisjet te cilat operojne brenda vend punishtes, te jen patjeter me regjistrim!

#### **Pretendimi nr. 2:**

MJETET QË DUHET TË DËSHMOHEN ME DUD DOGANOR APO FAKTURË TË BLERJES;

**Makinë hidraulike speciale për vendosjen dhe nivelizimin e pusetave 540 bar,( copë 1)**

Kemi kerkuar nga AK qe te na e spjegoj teknikisht operimin e kesaj paisje, pasi qe ne paramase nuk kemi asnje pozicion te pusetave dhe AK ne kërkesën ton per rishqyrtim nuk eshte përgjigjur fare ne kete pretendim!

#### **Pretendimi Nr 3.**

**Gjysmërimorkio special me sistem hidraulik për tërheqje të kabllove nëntokësor dhe ajror, (copë 1)**

Pas shqyrtimit te paramases e cila eshte pjes e DT per kete aktivitet te prokurimit, kërkesa e vendosur nga AK nuk eshte ne harmoni me paramasen dhe natyrën e punës, dhe si e tille kjo pasisje duhet te hiqet nga DT per kete aktivitet te prokurimit.

Kemi kerkuar nga AK me kërkesën per rishqyrtim qe te na e spjegoj teknikisht operimin edhe te kesaj paisje, pasi qe ne paramase nuk kemi asnje pozicion qe nderlidhet e paisjen e kërkuar ne FDT, por AK nuk eshte përgjigjur fare ne kete pretendim.

Kërkesat e tilla te vendosura ne DT bien ne kundërshtim me nenin 1 te LPP-se QELLIMIN, nenin 6 EKONOMICITETI DHE EFIKASITETI, nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Kerkojme qe edhe keto dy makineri te largohen pasi qe nuk kan lidhje me paramase dhe punet qe kan per tu realizuar ne kete dosje tenderi!

**Bazuar ne Sqarimet e lartcekura kërkojmë nga OSHP qe te merr:**

### **VENDIM**

**Te aprovohet e bazuar ne tërësi ankesa e OE Arching Group shpk, dhe te obligohet AK Komuna e Shtimes qe kërkesat diskriminuese dhe favorizuese te hiqen nga DT.**

Per fund

Kërkohehet qe AK:

- Të heqë ose të riformulojë kërkesat e shtuara teknike që janë shumë specifike dhe kufizuese.
- Të përdorë formulime të hapura si “ose ekuivalente” për të mundësuar konkurrencë më të gjerë.
- Të sigurojë transparencë dhe barazi në trajtim sipas Ligjit për Prokurimin Publik (nenet 7 dhe 28).
- Të sqarojë çdo kufizim teknik me arsyetime objektive që lidhen me qëllimin e kontratës dhe sigurinë e projektit.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Do te percaktohen ne fazat vijuese

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*